



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 50, Datë 27.03.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2MW, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma ‘a’ të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”; nenit 5, pika 1 gërma “a”; nenit 10, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 19 pika 1 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt konçensionit”, i ndryshuar me Vendim e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 12.10.2016, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.03.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2MW, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier.

Konstatoi se:

Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213 Prot., datë 12.03.2019, ka paraqitur aplikimin, për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike me fuqi të instaluar 2 MW.

Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratën me nr. 6380 Rep. dhe nr. 2756 Kol. datë 31.12.2018, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e centralit fotovoltaike “SMART WATT” sh.p.k me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Topojë, Qarku Fier.

Aplikimi i shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.5 gërma “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2: **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë), **gërma “e”** (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin), **gërma “g”** (saktësimi mbi dokumentat që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (Në Kontratën e Qirasë Nr. 968 Rep dhe Nr. 275 Kol, datë 24.05.2018, është konstatuar mungesa e faqjes së fundit me nënshkrimet përkatëse).
- Dokumentacioni teknik, për Centralet Solare, pika 4.4.1. (Të dhëna specifike për Centralin Solar të plotësuar nga aplikuesi), Pika 4.4.2 (Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin të plotësuar nga aplikuesi), Pika 4.4.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik, **gërma “a”** (Studimi i fizibilitetit), **gërma “b”** (Grafiku i zbatimit të projektit), **gërma “c”** (Oponenca teknike e projektit), **gërma “d”** (Plani i biznesit). Pika 4.5 plotësimin e lejeve të munguara nga institucione të tjera, **gërma “a”**, Miratimin e OST ose OSHE-s, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmentimit ose shpërndarjese . OSHEE sh.a në shkresën nr. 26578/1 datë 14.09.2018 ka rekomanduar marrjen e miratimit për pikën e lidhjes nga OST sh.a..
- Subjekti në Formatin e Aplikimit ka paraqitur të dhënat si vijon: Centrali prodhues 2 MW - “Smart Watt” sh.p.k, tipi i centralit Solar, tipi i panelave Polikristalin, sipërfaqja e panelave 30.000 m², orët e punës në një vitë 2.010 h/vit, fuqia e instaluar 2 MW, numri i njësisve gjeneruese dhe fuqia e instaluar 312x0,0064 MW=2 MW, niveli i tensionit kV=35kV, N/st ku lidhet centrali linja 35/10kV, Hoxharë, tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmentimi ku lidhet centrali 35 kV. Prodhimi vjetor i energjisë $E_{vjet}=31.36MWh$, rendimenti 15.5%, viti i ndërtimit 2019, data e fillimit të operimit 2019, jetëgjatësia e centralit 25 vjet. Sa i përket këtyre të dhënave do ti kërkohen subjektit sqarimet përkatëse duke qënë se bien ndesh me ato të pasqyruara në studimin e fizibilitetit dhe me kontratën e nënshkruar me MIE.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me fuqi të instaluar 2 MW, të ndodhur në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojne subjektin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI